



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit  
P- 47  
Prishtinë, më 2 shkurt 2012

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 2 SHKURT 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

**Kryetari** deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me këtë

**R e n d i t e**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas.

## **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Hashim Deshishku, Fadil Demaku, Alma Lama, Teuta Haxhiu, Sevdije Lama, Sabri Hamiti, Shaip Muja, Rexhep Selimi, Time Kadrijaj dhe Sali Asllanaj. Diskutimet e deputetëve janë dhënë të plota në transkript.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Alma Lama, parashtoi pyetje për ministrin, Ramë Buja, në lidhje me përgatitjet e Ministrisë që ai drejton për realizimin e projektit të ashtuquajtur të teksteve të integruara për arsimin fillor në Kosovë.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Kimete Bytyçi, parashtoi pyetje për ministrin, Dardan Gashi, në lidhje me veprimet e Ministrisë që ai drejton, pas vendimit të Gjykatës Supreme lidhur me pezullimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 02/46, të 2 nëntorit 2011.

Ministri Dardan Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyçi.

Deputetja Lumnije Morina, parashtoi pyetje për ministrin, Bedri Hamza, në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me punëtorët e Fabrikës së Tubave në Ferizaj.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetes Lumnije Morina.

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj, në lidhje me mosrealizimin e kërkesës së tij për të marrë kopje të dokumenteve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, lidhur me kërkesën për ofertim për investitorët e parakualifikuar në procesin e privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj, në lidhje me atë se a do ta procedojë Qeveria në Kuvend, vendimin për privatizimin e PTK-së.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

## **3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur me 26 janar 2012**

Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të 26 janarit 2012, pa vërejtje.

## **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike**

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike.

Ministri **Besim Beqaj** tha se miratimi i këtij projektligji do të vendosë një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore e cila do të jetë në harmoni me ligjet e BE-së.

Më tej ai tha se ky projektligj synon të krijojë rrethana të favorshme për zhvillimin e tregtisë elektronike, përdorimin e transaksioneve elektronike si nga Qeveria, bizneset, por edhe nga qytetarët.

Ministri Besim Beqaj, në vazhdim theksoi se projektligji në fjalë adreson çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e shoqërisë informatike, sigurinë e transaksioneve dhe shkëmbimeve elektronike, komunikimet komerciale dhe nënshkrimet elektronike.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Besim Beqaj i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Buzhala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët: Haki Demolli, Myzejene Selmani, Hashim Deshishku dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

|                |     |
|----------------|-----|
| Për-----       | 51, |
| Kundër-----    | 0,  |
| Abstenime----- | 0.  |

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike**

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike.

Zëvendëskryeministrja **Mimoza Kusari-Lila**, tha se fusha e turizmit paraqet një degë shumë të rëndësishme të ekonomisë së një vendi.

Më tej ajo tha se e veçanta e këtij projektligji qëndron në formimin e Organizatës Nacionale Turistike të Kosovës, e cila do të zhvillojë dhe promovojë produktet turistike, si në rrafshin nacional, ashtu edhe në atë lokal.

Më pas ajo u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari-Lila i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Buzhala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hashim Deshishku, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët, Aurora Bakalli, Lutfi Zharku, Gëzim Kelmendi dhe zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari-Lila, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 89,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror**

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Ministri **Fehmi Mujota** tha se nevoja për miratimin e këtij projektligji është e domosdoshme duke pasur parasysh zhvillimin e sektorit të aviacionit civil dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e tregut të aviacionit civil.

Më tej ai tha se projektligji parasheh formimin e Agjencisë për Shërbimin e Navigimit Ajror me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të trafikut ajror, të përdorimit më të mirë të teknologjive të reja, të përshejtimit të projekteve të modernizimit në mënyrë që t’i përgjigjet më mirë nevojave të grupeve të interesit në komunikacionin ajror.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Fehmi Mujota i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Agim Kuleta, Sali Morina, Hashim Deshishku dhe ministri Fehmi Mujota, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 79,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas**

**Kryesuesi** i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndihmë juridike falas.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, e arsyetoi anëtari i këtij Komisioni, deputeti Behar Selimi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputetja Albulena Haxhiu, diskutimi i së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 15.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndihmë juridike falas.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 13:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale